



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**  
**Nr. 25 Datë 25.11.2020**

**PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR FUNKSIONARIN PUBLIK ZJ. ADELINA AGO KALOTI, ME FUNKSION KËSHILLTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË KAVAJË, QARKU TIRANË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 12 e Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 156/80 prot., datë 28.10.2020, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues zj. Adelina Ago Kaloti, këshilltar në Këshillin Bashkiak Kavajë

**VËREN**

**I.**

a) Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.



**Nr. 25 i vendimit**

**Data 25.11.2020 e vendimit**

“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zj. Adelina Ago Kaloti, me funksion këshilltar në këshillin e bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

- b) Zj. Adelina Ago Kaloti, si kandidat i listës shumemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit më datë 13.05.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Subjekti vetëdeklarues zj. Adelina Ago Kaloti, tek formulari i vetëdeklarimit datë 13.05.2019 ka deklaruar se:

- i. Pyetjes 7 "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj (me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo të hyrje daljes në një territor të një shteti të huaj" ka deklaruar se është dëbuar nga Gissen, Gjermani në vitin 2018 për tejkalim të afatit të qëndrimit;
  - ii. Po këtu, pyetjes 8 "A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj" ka deklaruar se ka qëndruar në Gissen, Gjermani për arsye shëndetësore për periudhën 08.09.2016-29.11.2018.
  - i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3615 prot., datë 15.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 3617 prot., datë 15.05.2019, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
  - ii. Me shkresën nr. V-1512/1 prot., datë 16.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues zj. Adelina Ago Kaloti figuron me statusin "I Padënuar", brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
  - iii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka paraqitur të dhënat personale për subjektin deklarues zj. Adelina Ago Kaloti.
  - iv. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 561 datë 18.05.2019 ka vendosur të njoftojë KZAZ Nr. 42, të vijojë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore.
- c) Më datë 08.11.2019, KQZ njoftojt me shkresën nr. 4090 prot., për krijimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, si pasojë e dorëheqjes nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Guxim Kola, i propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.
- d) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe neni 164 të Kodit Zgjedhor, ka njoftuar me shkresën nr. 14769/1prot., datë 20.11.2019, zj. Adelina Kaloti të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit si kandidati i radhës të cilit i takon mandati për anëtar në Këshillin Bashkiak Kavajë, Qarku Tiranë.
- i. Më datë 27.11.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", subjekti vetëdeklarues ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit me numër unik 13731.



- ii. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për anëtar në Këshillin Bashkiak, ku rezultoi se subjekti ka deklaruar në rubrikën I. “Të dhëna personale”, gërma “b”, “Gjenealitetet e mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga “Llano” në “Kaloti”. I është përgjigjur me “jo” të gjitha pyetjet e tjera.
- iii. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresat nr. 14896 prot., datë 05.12.2019 dhe nr. 14897 prot., datë 05.12.2019, ka kërkuar përkatësisht informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Me shkresën nr. 9896/1 prot., datë 17.01.2019 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka paraqitur të dhënat personale për subjektin deklarues zj. Adelina Ago Kaloti. Referuar këtyre të dhënave rezultoi se subjekti nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- iv. Me shkresën nr. V-3680/1 prot., datë 11.12.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues zj. Adelina Ago Kaloti figuron me statusin “I padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- v. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 01, datë 14.01.2020, vërejti se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjidhshmërisë dhe vendosi të njoftojë Këshillin Bashkiak Kavajë të vijojë procedurat e mëtejshme për dhënien e mandatit.

## II.

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të detyrave të përcaktuara në paragrafin “ç”, pika 3 e Kreu V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për shkak të deklarimit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti anëtar i BE-së, me shkresën nr. 89 prot., datë 22.01.2020 ka përcjellë të dhënat e administruara nga KQZ për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin deklarues zj. Adelina Ago Kaloti, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë.
- b) Me shkresën nr. 156/80 prot., datë 28.10.2020, Prokurori i Përgjithshëm, Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Drejtorisë së Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, për subjektin zj. Adelina Ago Kaloti, me funksion Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Kavajë.
- c) Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin zj. Adelina Ago Kaloti me funksion Këshilltar në Këshillin e



Bashkië Kavajë”, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. V-4010/1 prot., datë 27.04.2020 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 23.04.2020, sipas të cilës rezulton se zj. Adelina Ago Kaloti, figuron “I Padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 857/1 prot., datë 17.02.2020, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit zj. Adelina Ago Kaloti, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se Këshilltari i Këshillit të Bashkisë Kavajë, zj. Adelina Ago Kaloti, ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile rubrikën e mbiemrit nga “Llana” në “Kaloti”, duke marrë mbiemrin e bashkëshortit.
- iii. Nga informacioni i përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme, nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Prokuroritë e Apelit dhe Apeleve dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit zj. Adelina Ago Kaloti nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qënë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- iv. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit deklaroi se zj. Adelina Ago Kaloti nuk ka qënë e ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë vepre penale. Nuk ka gjenealitete të tjera të regjistruara, përveçse sa ka deklaruar.
- v. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme përgjigjen me nr.3067/1 prot, datë 13.10.2020, sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe në Komisariatit e Policisë Kufitare Rinas, shtetësja Adelina Ago Kaloti, është kthyer “Deportuar”, nga Gjermania në datë 29.11.2017, me motivimin refuzim azili ekonomik, dëbim me afat 2-vjeçar.
- vi. Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezulton se zj. Adelina Ago Kaloti, ka të njëjtat gjenealitete të cilat i ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit. Në sistem rezulton se kjo shtetase është e deportuar nga Gjermania në datë 29.11.2017.
- vii. Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 201/1 prot., datë 30.09.2020, ka përcjellë përgjigjen zyrtare të autoriteteve të drejtësisë së Zyrës Federale të Republikës së Gjermanisë. Referuar shkresës, autoritetet gjermane të drejtësisë janë shprehur se nuk mund t’i përgjigjen kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme, për sa kohë



**Nr. 25 i vendimit**

**Data 25.11.2020 e vendimit**

“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zj. Adelina Ago Kaloti, me funksion Këshilltar në këshillin e bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

kjo shtetase nuk është në hetim penal nga ana e organit të prokurorisë së Republikës së Shqipërisë.

### III.

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:
- b) Subjekti vetëdeklarues zj. Adelina Ago Kaloti, tek formulari i vetëdeklarimit datë 13.05.2019 ka deklaruar se:
- iii. Pyetjes 7 *“A është marrë ndonjëherë për ku masa e dëbimit nga një shtet i huaj (me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo të hyrje daljes në një territor të një shteti të huaj”* subjekti vetëdeklarues, ka deklaruar se është dëbuar nga Gissen, Gjermani në vitin 2018 për tejkalim të afatit të qëndrimit;
  - iv. Po këtu, pyetjes 8 *“A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj”* subjekti vetëdeklarues, ka deklaruar se ka qëndruar në Gissen, Gjermani për arsye shëndetësore për periudhën 08.09.2016-29.11.2018.
- c) Subjekti vetëdeklarues zj. Adelina Ago Kaloti, tek formulari i vetëdeklarimit datë 27.11.2019 ka deklaruar:
- i. në rubrikën I. *“TË DHËNA PERSONALE”*, PIKA B, *“Gjenezalitete të mëparshme”* të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenezalitete e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga *“Llano”* në *“Kaloti”*.
- d) Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 156/80 prot atë 28.10.2020 ka njoftuar rezultatet e verifikimit të thelluar sipas së cilës, rezultoni e provuar se subjekti vetëdeklarues zj. Adelina Ago Kaloti, është kthyer *“Deportuar”*, nga Gjermania në datë 29.11.2017, me motivimin refuzim azili ekonomik, dëbim me afat 2-vjeçar
- e) Ligji nr. 138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenezalitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).
- f) Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është miratuar bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015.
- g) Këto të dhëna referuar ligjit 138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016, janë të dhëna të cilat do të disponohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në çdo rast, mosdeklarimi i tyre nuk shmanë verifikimin e plotë dhe të gjithanshëm.
- h) Referuar përgjigjes së Prokurorisë së Përgjithshme nga ku rezultoni se zj. Adelina Kaloti është kthyer *“Deportuar”*, nga Gjermania në datë 29.11.2017, me motivimin refuzim azili ekonomik, dëbim me afat 2-vjeçar, nuk përbën kusht për ndalimin për zgjedhjen në funksionin e këshilltarit në këshillin e bashkisë Kavajë. Në formularin e vetëdeklarimit, pyetja 7: *“A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj”*, përcaktohet qartë rasti i përjashtimit: *“Me përjashtim të*



*rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj*”.

- i) Në përfundim nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, rezultatet e verifikimit të të dhënanave nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në vijim nuk është në kushtet e ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të po këtij ligji.
- j) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publik të trajtuar sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, të dhënat e padeklaruara, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo.
- k) Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.
- l) Pyetja 7 në Formularin e vetëdeklarimit ka përcaktuar si rast përjashtimor deklarimin në formular të dëbimit ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje daljes në një territor të një shteti të huaj.
- m) Konstatohet se zj. Adelina Kaloti ka deklaruar në formularin e datës 13.05.2019 se nuk disponon të dhënat e dëbimit, ndonëse ka përcaktuar si arsye të dëbimit tejkalimin e afateve të qëndrimit, ndërkohë që nuk ka patur detyrimin të deklarojë dëbimin nëse ai ishte i lidhur ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigrimit. Ndërkohë në formularin e datës 27.11.2019 nuk ka deklaruar këtë dëbim, por ka saktësuar se ka jetuar në Giessen, dhe ka saktësuar periudhën duke përcaktuar periudhën 08.09.2016 – 29.11.2017 dhe jo vitin 2018 sikundër ishte në deklaratën e parë.
- n) Referuar nenit 33, 42, 47 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 11.11.2020 ora 10:00 thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, zj. Adelina Ago Kaloti, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes. Njoftimi iu bë e njohur me mjetet e komunikimit telefonik. Njoftimi u afishua edhe në ambjentet publike të KQZ-së si dhe në faqen e internetit. Në datën dhe orën e përcaktuar zj. Kaloti nuk u paraqit në seancë.
- o) Referuar nenit 85 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me një njoftim të dytë caktoi seancën e dytë dëgjimore me subjektin deklarues zj. Adelina Ago Kaloti me datë 25.11.2020 ora 10:00. Njoftimi u afishua edhe në ambjentet publike të KQZ-së si dhe në faqen e internetit. Në datën dhe orën e përcaktuar zj. Kaloti nuk u paraqit në seancë.
- p) Referuar nenit 89 paragrafi “c” i Kodit të Procedurave Administrative procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, në rast se gjatë zhvillimit të procedurës administrativerezulton qartë se vendimi do të jetë në favor të palës.
- q) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publik të trajtuar sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, të dhënat e padeklaruara, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo.
- r) Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.
- s) Subjekti vetëdeklarues ka deklaruar në tërësi të dhëna me gabime, por që të kombinuara nxjerrin në pah arsyen se ajo ka jetuar dhe është dëbuar nga Gjermania për arsye emigrimi.



**Nr. 25 i vendimit**

**Data 25.11.2020 e vendimit**

“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zj. Adelina Ago Kaloti, me funksionin këshilltar në këshillin e bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

- t) Duke qenë se nga procesi i verifikimit nuk janë evidentuar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve si dhe fakti që ajo ka deklaruar se nuk disponon arsyet e dëbimit, shkak për të cilin nuk mund të japë një arsye të saktë të dëbimit, nuk përbën arsye për aplikimin e penaltetit të përcaktuar në paragrafin 3, germa “ç” të Kreut III të Vendimit të Kuvendit 17/2016.

Për sa më sipër subjekti deklarues zj. Adelina Ago Kaloti nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 12 e Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

### VENDOSA:

1. Konstatimin se zj. Adelina Ago Kaloti me detyrë anëtar i Këshillit Bashkiak Kavajë, Qarku Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Ilirjan CELIBASHI**



**Nr. 25 i vendimit**

**Data 25.11.2020 e vendimit**

“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për funksionarin publik zj. Adelina Ago Kaloti, me funksion këshilltar në këshillin e bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.